

MARRËVESHJE PËR RUAJTJEN E KONFIDENCIALITETIT NGA ANA E PUNËMARRËSIT

Kjo marrëveshje për ruajtjen e konfidencialitetit nga ana e Punëmarrësit ("Kontrata") bëhet e vlefshme në datën [DATA],

NDËRMJET: [EMRI I PUNËMARRËSIT] ("Punëmarrësi"), një individ me adresën e vet në:
[ADRESA E PLOTË]

DHE: [EMRI I KOMPANISË SUAJ] ("Kompania"), një shoqëri tregtare e themeluar sipas legjisllacionit shqiptar me adresën e selisë në:
[ADRESA JUAJ E PLOTË]

Në lidhje me punësimin nga Kompania dhe për vënien në dijeni për shkak të këtij punësimi, të informacionit konfidencial dhe sekret tregtar, Punëmarrësi i poshtëshënuar, bie dakord si më poshtë vijon:

1. KONFIDENCIALITETI

Punëmarrësi e pranon, që gjatë periudhës së punësimit të tij pranë Kompanisë, Punëmarrësi do të vihet në dijeni të informacioneve të vlefshme dhe të dhënave që përbëjnë sekret tregtar të Kompanisë. Punëmarrësi bie dakord që të ruajë konfidencialitetin e të gjithë këtij informacioni dhe të marrë masat e nevojshme për të parandaluar që ky informacion t'iu bëhet i ditur palëve të treta, gjatë dhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

Punëmarrësi pranon, që informacionet që përbëjnë sekret tregtar të Kompanisë, janë si më poshtë, por pa u kufizuar në to:

- a) Informacioni teknik: Metodrat, proceset, formulat, kompozimet, sistemet, teknikat, risitë, makineritë, programet kompjuterike dhe projektet kërkimore.
- b) Informacioni që lidhet me biznesin: listat e klientëve, të dhënat për cmimet, burimet e furnizimit, të dhëna financiare dhe të marketingut, prodhimit, apo sistemeve dhe planeve të tregtimit.

Punëmarrësi e kupton që kjo Marrëveshje nuk e ndalon atë që të punojë për një kompani tjetër, në vijim të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me Kompaninë, përse kohë, që Punëmarrësi nuk do t'i përdorë dhe as do t'i zbulojë këto informacione që janë konfidenciale dhe në zotërim vetëm të Kompanisë.

2. PËRDORIMI

Punëmarrësi nuk do t'i përdorë informacionet konfidenciale dhe të dhënat që përbëjnë sekret tregtar të Kompanisë, përveçse në masën që është e nevojshme për të ofruar shërbimet dhe mallrat e kërkuara nga Kompania.

3. ZBATIMI

Punëmarrësi pranon që nëse ai/ajo shkel ndonjërin prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, Kompanisë i lind e drejta që të zbatojë këtë Marrëveshje përpara gjykatës kompetente. Punëmarrësi kupton dhe pranon që çdo lloj shkeljeje e kësaj marrëveshjeje do t'i shkaktojë dëme të pakthyeshme Kompanisë dhe se dëmshpërblimi në para, nuk do të jetë kompensim i përshtatshëm për Kompaninë. Përveç kësaj, Kompania do të kërkojë të drejtat dhe kompensime sipas dispozitave të parashikuara nga ligji, apo statuti.

4. NDËRPRERJA

të gjitha materialet që i janë dorëzuar Punëmarrësit nga ana e Kompanisë si dhe të gjitha materialet e përgatitura nga Punëmarrësi në lidhje me punësimin nga Kompania punëdhënëse, duke përmendur, por pa u kufizuar në to: dokumente, modele, kode burimore, diseno, diagrame dhe lista, si dhe të gjitha kopjet e tyre, do t'i kthehen menjëherë Kompanisë, në përfundim të kontratës së punësimit të Punëmarrësit nga Kompania.

5. PRONËSIA

Punëmarrësi bie dakord që të gjitha punimet dhe përpunimet, që ai ka krijuar nën drejtimin, ose në lidhje me detyrat e ngarkuara nga Kompania, do të jenë ekskluzivisht pronësia e Kompanisë, dhe se cdo lloj e drejte autori, apo interesa pronësore mbi to do t'i takojnë vetëm Kompanisë, dhe se dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje do të gjejnë zbatim plotësisht në lidhje me të gjitha këto punime dhe përpunime.

6. LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo marrëveshje është në përputhje me dispozitat e legjislacionit të zbatueshëm, në Republikën e Shqipërisë, në fuqi, në datën e lidhjes së kësaj kontrate.

7. DËMSHPËRBLIMI

Punëmarrësi pranon që të paguajë kushtin penal në para në shumën prej [SHUMA NË PARA] për cdo lloj shkeljeje të kësaj marrëveshjeje për ruajtjen e informacionit të konsideruar konfidencial, dhe sekret tregtar, sipas kësaj Marrëveshjeje.

8. MARRËVESHJA E DETYRUESHME

Nëse ndonjë prej pikave të kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, për çfarëdolloj arsyeje, të poshtëshënuarit bien dakord, që ajo pike të hiqet, pa cënuar vlefshmërinë, apo zbatueshmërinë e pikave të tjera të Marrëveshjes, si dhe pa cënuar integritetin e Marrëveshjes si të tillë.

Kjo marrëveshje bëhet e detyrueshme për palët, pasardhësit e tyre, të deleguarit dhe përfaqësuesit e tyre.

Në dëshmi të dakordësisë së arritur, secila palë, deklaron me vullnet të lirë, se e lidh këtë kontratë në vendin [VENDI I LIDHJES] në datën e treguar më poshtë, duke vendosur nënshkrimin e vet.

KOMPANIA

PUNËMARRËSI

Nënshkrimi i autorizuar

Nënshkrimi i autorizuar

Emri/Mbiemri si dhe Pozicioni (me gërma shtypi)

Emri/Mbiemri si dhe Pozicioni (me gërma shtypi)